

OJQ ACTION FOR DEMOCRATIC SOCIETY

NR: 601025085

Raporti i Auditori i Pavarur dhe Pasqyrat Financiare
për vitin e përfunduar më 31 Dhjetor 2024

Përmbajtja

RAPORTI I AUDITORIT TË PAVARUR	3
DEKLERATA E PAJTUSHMERISË	6
I. Pasqyra e pozitës financiare.....	7
II. PASQYRA GJITHËPËRFSHIRSE E TË ARDHURAVE.....	8
III. PASQYRA E NDRYSHIMEVE NË FONDE.....	9
IV. PASQYRA E RRJEDHËS SË PARASË	10
V. Shënimet për “Pasqyrat Financiare”	11

RAPORTI I AUDITORIT TË PAVARUR

Për menaxhmentin e OJQ ACTION FOR DEMOCRATIC SOCIETY

Opinion

Ne kemi audituar pasqyrat financiare të **OJQ ACTION FOR DEMOCRATIC SOCIETY** (Organizata), të cilat përfshijnë pasqyrën e pozicionit financiar me datën 31 Dhjetor 2024, pasqyrën e të ardhurave gjithëpërfshirëse, pasqyrën e ndryshimeve në fonde dhe pasqyrën e flukseve të parasë për vitin që mbyllet me këtë datë, si edhe shënimet për pasqyrat financiare, përfshirë një përmbledhje të politikave kontabël më të rëndësishme.

Sipas opinionit tonë, pasqyrat financiare bashkëlidhur paraqesin drejt, në të gjitha aspektet materiale, pozicionin financiar të Organizatës me datën 31 Dhjetor 2024, dhe performancën financiare e flukset e parasë për vitin që mbyllet në këtë datë, në pajtim me Standardin Ndërkombëtarë të Raportimit Financiar për Ndërmarrjet e Vogla dhe të Mesme (SNRF për NVM-të).

Baza për opinionin

Ne e kryem auditimin tonë në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit (SNA-të). Përgjegjësitë tona sipas këtyre standardeve janë përshkruar në mënyrë më të detajuar në seksionin e raportit ku jepen Përgjegjësitë e Audituesit për Auditimin e Pasqyrave Financiare. Ne jemi të pavarur nga Organizata në përputhje me kërkesat etike që janë të zbatueshme për auditimin e pasqyrave financiare në Kosovë, dhe kemi përmbushur përgjegjësitë e tjera etike në përputhje me këto kërkesa. Ne besojmë se evidenca e auditimit që kemi siguruar është e mjaftueshme dhe e përshtatshme për të dhënë një bazë për opinionin tonë.

Raport mbi Pajtueshmërinë Shtesë Ligjore dhe Rregullative:

Për më tepër, organizata dorëzon raporte specifike në përputhje me Ligjin Nr. 06/L-116, i cili ndryshon dhe plotëson Ligjin nr. 05/L-090 që ka të bëjë me sponsorizimet në fushën e kulturës, rinisë dhe sportit.

Pasqyrat po ashtu janë përgatitur dhe janë përshtatur ashtu që mos të vijnë në kundërshtim me Ligjet apo Rregulloret tatimore si dhe sipas kërkesave ligjore mbi raportimin e OJQ-ve që aktualisht janë në fuqi në Republikën e Kosovës, si dhe në përputhje me kërkesat e ligjit nr. 06/L-043 Për Lirinë e Asocimit në Organizatat Jo-qeveritare me qëllim të raportimit në Zyrën e Rregullatorit të OJQ-ve.

Informacione të tjera të ndryshme nga Pasqyrat Financiare dhe Raporti i Audituesit mbi to
Menaxhmenti është përgjegjës për informacionet e tjera. Opinioni ynë mbi pasqyrat financiare nuk mbulon informacionet e tjera dhe ne nuk shprehim ndonjë lloj konkluzioni që jep siguri në lidhje me këto informacione.

Në lidhje me auditimin e pasqyrave financiare, ne kemi përgjegjësinë të lexojmë informacionet e tjera dhe të vlerësojmë nëse këto informacione kanë inkoherenca materiale me pasqyrat financiare apo me njohjen që ne kemi marrë gjatë auditimit ose përndryshe, nëse duket se janë me anomali materiale. Nëse, bazuar në punën e kryer, ne arrijmë në përfundimin se në këto informacione ka një anomali materiale, atëherë ne duhet të raportojmë për këtë fakt. Ne nuk kemi asgjë për të raportuar.

Përgjegjësitë e Menaxhmentit dhe të Personave të Ngarkuar me Qeverisjen në lidhje me Pasqyrat Financiare

Menaxhmenti është përgjegjës për përgatitjen dhe paraqitjen e drejtë të pasqyrave financiare në përputhje me SNRF për NVM-të, dhe për ato kontrole të brendshme që Menaxhmenti i gjykon të nevojshme për të bërë të mundur përgatitjen e pasqyrave financiare që nuk përmbajnë anomali materiale, qoftë për shkak të mashtrimit apo gabimit.

Në përgatitjen e pasqyrave financiare, Menaxhmenti është përgjegjës për të vlerësuar aftësinë e Organizatës për të vazhduar në vijimësi, duke dhënë informacion nëse është e zbatueshme për çështjet që kanë të bëjnë me vijimësinë dhe duke përdorur parimin kontabël të vijimësisë përveç se në rastin kur Menaxhmenti synon ta likujdojë Organizatën ose të ndërpresë aktivitetet, ose nëse nuk ka alternativë tjetër reale përveç sa më sipër.

Ata që janë të ngarkuar me qeverisjen janë përgjegjës për mbikëqyrjen e procesit të raportimit financiar të Organizatës.

Përgjegjësitë e Audituesit për Auditimin e Pasqyrave Financiare

Objektivat tona janë që të arrijmë një siguri të arësyeshme lidhur me faktin nëse pasqyrat financiare në tërësi nuk kanë anomali materiale, për shkak të mashtrimit apo gabimit, dhe të lëshojmë një raport auditimi që përfshin opinionin tonë. Siguria e arësyeshme është një siguri e nivelit të lartë, por nuk është një garanci që një auditim i kryer sipas SNA-ve do të identifikojë gjithmonë një anomali materiale kur ajo ekziston.

Anomalitë mund të vijnë si rezultat i gabimit ose i mashtrimit dhe konsiderohen materiale nëse, individualisht ose të marra së bashku, pritet që në mënyrë të arësyeshme të influencojnë vendimet ekonomike të përdoruesve, të marra bazuar në këto pasqyra financiare.

Si pjesë e një auditimi në përputhje me SNA-të, ne ushtrojmë gjykim profesional dhe ruajmë skepticizmin profesional gjatë auditimit. Ne gjithashtu:

- Identifikojmë dhe vlerësojmë rrezikun e anomalive materiale të pasqyrave financiare, qoftë për shkak të mashtrimeve apo gabimeve, dizajnojmë dhe kryejmë procedurat e auditimit në përgjigje të këtyre rreziqeve, dhe sigurojmë evidencë të auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të siguruar një bazë për opinionin tonë. Rreziku i mos zbulimit të një anomalie material që rezulton nga mashtrimi është më i lartë sesa rreziku që rezulton nga gabimi, pasi mashtrimi mund të përfshijë marrëveshje të fshehta, falsifikime, lëshime të qëllimshme, keqinterpretime apo shkelje të kontroleve të brendshëm.
- Marrim një kuptim të kontrollit të brendshëm të përshtatshëm për auditim me qëllim të dizajnit të procedurave të auditimit që janë të përshtatshme për rrethanat, por jo për qëllimin e shprehjes së një opinion mbi efektivitetin e kontroleve të brendshme të Kompanisë.
- Vlerësojmë përshtatshmërinë e politikave kontabël të përdorura dhe arsyeshmërinë e përlllogaritjeve kontabël dhe shpalosjeve përkatëse të bëra nga menaxhmenti.
- Nxjerrim një përfundim lidhur me përshtatshmërinë e përdorimit të bazës së kontabilitetit mbi parimin e vijimësisë nga menaxhmenti, në bazë të evidencave të auditimit të

siguruara, nëse ekziston një pasiguri materiale në lidhje me ngjarjet ose kushtet që mund të hedhin dyshime domethënëse mbi parimin e vijimësisë të Kompanisë.

Nëse arrijmë në përfundim se ekziston një pasiguri materiale, ne duhet të tërheqim vëmendjen në raportin tonë të auditorit për shpalosjet përkatëse në pasqyrat financiare ose, nëse këto shpalosje janë të papërshtatshme, të modifikojmë opinionin tonë. Konkluzionet tona të auditimit bazohen në evidencat e auditimit të siguruara deri në datën e raportit tonë të auditimit. Megjithatë, ngjarje ose kushte në të ardhmen mund të ndikojnë që Kompania të ndërpres veprimtarinë.

- Vlerësojmë paraqitjen e përgjithshme, strukturën dhe përmbajtjen e pasqyrave financiare, duke përfshirë informacionet shpjeguese të dhëna, dhe nëse pasqyrat financiare paraqesin transaksionet dhe ngjarjet e ndodhura në mënyrë që të arrijnë një paraqitje të drejtë.

Ne komunikojmë me personat e ngarkuar me qeverisjen e Kompanisë përveç të tjerash, edhe për fushëveprimin e planifikuar dhe kohën e auditimit dhe gjetjet e rëndësishme të auditimit, përfshirë çdo mangësi të rëndësishme të kontrollit të brendshëm që ne kemi identifikuar gjatë auditimit.

Pavarësia

Ne jemi të pavarur nga organizata në përputhje me kërkesat e Bordit të Standardeve Ndërkombëtare të Etikës për Kodin e Kontabilistëve të Etikës së Kontabilistëve Profesionistë (Kodit IESBA) dhe të kërkesave të ligjit No.06/L-032, ne i kemi përmbushur edhe përgjegjësitë tona të tjera etike në përputhje me Kodin IESBA dhe kërkesat ligjore që dalin nga ligji No.06/L-032 dhe nga Udhëzimi Administrativ No. 02/2019.



Vega Audit SH.P.K.

No.Licencës:39

Nexhit Shala, auditor ligjor

Nënshkrimi


No.Licencës:99

28 mars 2025


Emri i organizatës	ACTION FOR DEMOCRATIC SOCIETY
Lloji organizatës	OJQ
Numri I regjistrimit	51131517
NRF:	601025085
Adresa:	RR “Hajdar Dushi” 22A/1

DEKLERATA E PAJTUSHMERISË

Bazuar në njohurit tona më të mira, deklarojmë që pasqyrat financiare që përfundojnë më 31 dhjetor 2024, paraqesin në mënyrë të drejtë dhe të vërtetë pozicionin financiar të Organizatës dhe rezultatin e saj financiar, si dhe rrjedhën e parasë për vitin e përfunduar në këtë datë në përputhje me kërkesat e Ligjit Nr. 06/L- 032 për Kontabilitet, Raportim Financiar dhe Auditim.



Shkelzen Osmani
Drejtori i përgjithshëm/ekzekutiv
OJQ ACTION FOR DEMOCRATIC
SOCIETY




Blerina Rexhaj Dreshaj
Menaxhere e financave

Prishtinë
28 shkurt 2025


I. PASQYRA E POZITËS FINANCIARE

Euro	Shënimet	31 dhjetor 2024	31 dhjetor 2023
PASURITË			
Pasuritë afatshkurtra			
Paraja dhe ekuivalentët e parasë	4	59,642	61,323
Llogaritë e arkëtueshme tregtare dhe të tjera	5	-	6,593
Pasuritë Tjera	6	-	-
Gjithsej pasuritë afatshkurtra		59,642	67,916
Pasuritë afatgjata			
Prona, pajisjet dhe impiantet	7	11,750	5,719
Gjithsej pasuritë afatgjata		11,750	5,719
Gjithsej pasuritë		71,393	73,636
DETYRIMET DHE EKUITETI			
DETYRIMET			
Detyrimet afatshkurtra			
Llogaritë e pagueshme tregtare dhe të tjera	8	-	-
Detyrimet e tjera afatshkurtra	9	71,393	73,636
Gjithsej detyrimet afatshkurtra		71,393	73,636
Detyrimet afatgjata			
Gjithsej detyrimet afatgjata		-	-
Gjithsej detyrimet		71,393	73,636
FONDET			
Fondi themelues i organizatës (kumulativ)	10	-	-
Tepricat / (Mungesat) e vitit	14.b	-	-
Rezervat e tjera		-	-
Gjithsej fondet		-	-
Gjithsej fondet dhe detyrimet		71,393	73,636

Këto pasqyra financiare janë aprovuar për publikim më 28 shkurt 2025 dhe nënshkruar nga:



Shkelzen Osmani
 Drejtori i përgjithshëm/ekzekutiv
 OJQ ACTION FOR DEMOCRATIC
 SOCIETY



Blerina Rexhaj Drëshaj
 Menaxhere e financave

Shënimet shoqëruese nga 11 deri 19 janë pjesë përbërëse të këtyre pasqyrave financiare.

II. PASQYRA GJITHËPËRFSHIRSE E TË ARDHURAVE

Euro	Shënimi	Për vitin që përfundon me 31 dhjetor 2024	Për vitin që përfundon me 31 dhjetor 2023
Të ardhura nga donacionet dhe subvencionet	11	229,530	70,471
Të hyrat aktivitetet e Organizates	12	-	-
Gjithsej te hyrat		229,530	70,471
Të ardhurat tjera	11	-	-
Shpenzimet e shpërndarjes	13.a	(157,186)	(55,467)
Shpenzimet administrative	13.b	(69,653)	(14,631)
Shpenzimet e tjera	13.c	(2,691)	(374)
Gjithsej shpenzimet		(229,530)	(70,471)
Shpenzimet financiare	13.d	-	-
Të ardhurat financiare		-	-
Tepricat / (Mungesat) operative		-	(0)
Shpenzimet e tatimit në fitim	14	-	-
Tepricat / (Mungesat) i/e vitit		-	(0)
Të ardhurat tjera gjithëpërfshirëse:			
Diferencat këmbimore nga përkthimi i pasqyrave financiare te operacioneve të huaja, neto nga tatimi		-	-
Të ardhurat tjera gjithëpërfshirëse të vitit		-	-
Gjithsej të tepricat / (mungesat) gjithëpërfshirëse të vitit		-	(0)

III. PASQYRA E NDRYSHIMEVE NË FONDE

	Fondi	Tepricat / (mungesat)	Rezervat e tjera	Gjithsej
	€	€	€	€
Gjendja më 31 dhjetor 2022	-	-	-	-
Tepricat / (mungesat) e vitit	-	-	-	-
Diferencat nga përkthimet valutore	-	-	-	-
Ndarja e rezervave	-	-	-	-
Gjendja më 31 dhjetor 2023	-	-	-	-
Tepricat / (mungesat) e vitit	-	-	-	-
Diferencat nga përkthimet valutore	-	-	-	-
Ndarja e rezervave	-	-	-	-
Gjendja më 31 dhjetor 2024	-	-	-	-

IV. PASQYRA E RRJEDHËS SË PARASË

Euro	Shënimi	31 dhjetor 2024	31 dhjetor 2023
Rrjedha e parasë nga aktivitetet operative			
Fitimi / (humbja) i / e vitit		-	(0)
Rregullimet për zërat jo në para të shpenzimeve dhe të hyrave			
Zhvlërësimi i pronës, pajisjeve dhe impianteve		2,691	374
Dëmtimi i pronës, pajisjeve dhe impianteve		-	-
Amortizimi i pasurive të paprekshme		-	-
Humbjet nga dëmtimi në pasuritë e paprekshme		-	-
Ndryshimi i vlerës së pronës investuese		-	-
Të ardhurat financiare		-	-
Shpenzimet financiare		-	-
(Fitimi) / humbja nga shitja e pronës, fabrikës dhe pajisjeve		-	-
Shpenzimet e tatimit në fitim		-	-
		2,691	374
Ndryshimet në pasuritë dhe detyrimet operative			
(Rritja) / zvogëlim në llogaritë e arkëtueshme tregtare dhe të tjera		6,593	(3,923)
(Rritja) / zvogëlimi në stoqe		-	-
(Rritja) / zvogëlimi në pasuritë e tjera		-	-
Rritja / (zvogëlimi) në llogaritë e pagueshme tregtare dhe të tjera		-	-
Rritja / (zvogëlimi) në detyrimet e tjera		(2,243)	62,579
		7,041	59,030
Tatimi në fitim i paguar		-	-
Interesi i paguar		-	-
Rrjedha neto e parasë nga aktivitetet operative		7,041	59,030
Rrjedha e parasë nga aktivitetet investuese			
Pagesat për blerjet e pronës, pajisjeve dhe impianteve		(8,722)	(4,734)
Arkëtimet për shitjet e pronës, pajisjeve dhe impianteve		-	-
Pagesat për blerjet e pasurive të paprekshme		-	-
Arkëtimet për shitjen e pasurive të paprekshme		-	-
Interesi i arkëtuar		-	-
Dividendat e arkëtuara		-	-
Rrjedha neto e parasë nga aktivitetet investuese		(8,722)	(4,734)
Rrjedha e parasë nga aktivitetet financuese			
Deponimet e fondeve shtesë		-	-
Kthimet e fondeve		-	-
Arkëtimet nga kreditë dhe huatë		-	-
Ripagimi i kredive dhe huave		-	-
Pagesat e lizingut financiar		-	-
Rrjedha neto e parasë nga aktivitetet financuese		-	-
Rritja/(zvogëlimi) neto i parasë dhe ekuivalentëve të parasë		(1,681)	54,296
Paraja dhe ekuivalentët e parasë në fillim të vitit		61,322	7,027
Paraja dhe ekuivalentët e parasë në fund të vitit		59,642	61,322

V. SHËNIMET PËR “PASQYRAT FINANCIARE”

1. Informata të përgjithshme

Organizata quhet Action for Democratic Society, ajo mund të njihet edhe si ADS. Organizata është shoqatë jo-për përfitim, sipas definimit të dhënë në nenin 5.2 dhe 6 të Ligjit Nr. 03/L-134 Për Lirinë e Asociimit në Organizatat Joqeveritare në Republikën e Kosovës.

Organizata nuk do të bëjë shpërndarjen e çfarëdo fitimi neto ose të profitit si të tillë për asnjë individ. Pasuria, të ardhurat dhe profiti i organizatës do të përdoren për të mbështetur qëllimet joprofitabile të organizatës dhe nuk do të përdoren për të krijuar beneficione të veçanta individuale, qoftë në mënyrë të drejtpërdrejtë apo indirekte për asnjërin nga themeluesit, drejtorin, nëpunësin, ndonjë anëtar të shoqatës, ndonjë të punësuar apo donator të OJQ-së. Megjithatë pagesa e kompensimit të arsyeshëm për këta persona mund të bëhet për punën që këta persona kanë bërë për këtë organizatë.

Organizata e ka zyrën e saj qendrore në rrugën " Hajdar Dushi 22A/1", pa numër, Lagja Mati I (afër Institutit Gjyqësor të Kosovës), 10000, Prishtinë

Themelues të organizatës janë:

- Shkëlzen Osmani

Adresa: Rruga "Xheladin Hana", Kodra e Diellit, nr. 14/20, 10000, Prishtinë, Kosovë Numri i telefonit: 044 313-428

- Plator Avdiu

Adresa: Rruga "Muharrem Fejza", pa numër, Lagja Mati 1 (afër Institutit Gjyqësor të Kosovës), 10000, Prishtinë, Kosovë

Numri i telefonit: 044 283-527

- Armin Bushati

Adresa: Ulpiana, hyrja C 7/11 (tek restoranti "Symphony"), 10000, Prishtinë, Kosovë Numri i telefonit: 044 642-659

Përfaqësues i autorizuar i organizatës në Kosovë është Shkëlzen Osmani, rruga -Xheladin Hana", Kodra e Diellit, nr. 14/20, 10000, Prishtinë.

Qëllimi i ADS-së, është që përmes projekteve të ndryshme, të promovojë dhe të tregojë rëndësinë e integritit evropian të Kosovës si dhe prezantimin e vlerave demokratike.

2. Evidencat kontabël.

Kompania evidencat e veta kontabël dhe mirëmbajtjen librave të veta kontabël e bënë në baza akruale të kontabilitetit duke u bazuar në koston historike të transaksionit me vlerën reale të ndodhur të vlerësuar në valutën euro (€).

3. Politikat kryesore kontabël.

Janë koinsistente pra politikat e njejta kontabël aplikohen në menyrë të ngjajshme nga një periudhë në tjetër. Pasqyrat financiare janë përgaditur në baza krahasuese duke l paraqitur saldot e zërave për vitin vijues dhe vitin e kaluar. Periudha raportuese e organizatës përfshinë periudhën dymdhjetë mujore duke përfunduar me 31 Dhjetor të çdo viti kalendarik.

3.1. Baza e përgatitjes dhe parimi i vijimesisë

Këto pasqyra financiare janë përgatitur në përputhje me Standardin Ndërkombëtarë të Raportimit Financiar për Ndërmarrjet e Vogla dhe të Mesme (SNRF për NVM-të) të lëshuara nga Bordi i Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit, duke u bazuar në kostot historike dhe nuk ka pasur ndonjë revidim apo rivlerësim për asnjë zë të pasqyrave financiare.

Pasqyrat po ashtu janë përgatitur dhe janë përshtatur ashtu që mos të vijnë në kundërshtim me Ligjet apo Rregulloret tatimore si dhe sipas kërkesave ligjore mbi raportimin e OJQ-ve që aktualisht janë në fuqi në Republikën e Kosovës, si dhe në përputhje me kërkesat e ligjit nr. 06/L-043 Për Lirinë e Asocimit në Organizatat Jo-qeveritare me qëllim të raportimit në Zyrën e Rregullatorit të OJQ-ve.

Pasqyrat janë përgatitur me pohimin se OJQ-ja do të vazhdojë vijueshmerinë e aktiviteteve ushtrimore që i ka filluar.

3.2. Miratimi i standardeve të reja dhe të rishikuara

Në vitin 2024, Organizata ka miratuar të gjitha standardet e reja, të ndryshuara ose të rishikuara, si dhe të gjitha interpretimet e nxjerra nga Këshilli Kosovar për Raportim Financiar (KKRF) dhe Komiteti Ndërkombëtar i Interpretimeve të SNRF-ve që janë në kuadër të BSNK-së, që janë relevante për aktivitetet e tij dhe në fuqi në periudhat e raportimit vjetor duke filluar nga 1 janari 2024. Miratimi i standardeve dhe interpretimeve të reja dhe të rishikuara nuk kanë rezultuar në ndryshimin e politikave kontabël të organizates.

3.3. Valuta e paraqitur

Valuta prezantuese dhe raportuese e Kompanisë është Euro (EUR), ku në përputhje me rregulloret e Bashkimit Monetar Evropian dhe udhëzimeve të lëshuara nga Banka Qendrore e Kosovës, Euro ishte adoptuar si valuta e vetme legale në territorin e Kosovës prej datës 1 Janar 2002.

3.4. Shkëmbimi i valutës së huaj

Transaksionet në valutë të huaj janë shkëmbyer në monedhën funksionale duke përdorur kursin e këmbimit ekzistues në datat e transaksioneve. Fitimet dhe humbjet në valutat e huaja që rezultojnë nga rregullimet e transaksioneve të tilla si dhe nga ri-matjet e zërave monetar me kurset e këmbimit të fund vitit paraqiten si fitim ose humbje. Zërat jo-monetar të matur me kosto historike janë të shkëmbyera duke përdorur kursin e këmbimit në datën e transaksionit (jo të ri shkëmbyera). Zëra jo-monetar të matur me vlerën e drejtë janë shkëmbyer duke përdorur kursin e këmbimit në datën kur është përcaktuar vlera e drejtë

3.5. Njohja.

Organizata bënë njohjen fillestare të të gjitha pasurive qofshin ato të trupëzuara apo të pa trupëzuara por edhe detyrimet si ato ligjore një ashtu edhe ato kontraktuale në datën

në të cilin ato lindin. Të gjitha pasuritë dhe detyrimet tjera janë të njohura në datën e tregëtimit të tyre në të cilën entiteti bëhet pale e obliguar ndaj dispozitave kontraktuale për instrumentin përkatës.

3.6. Matja me vlerën e tregut.

Te gjitha pasuritë dhe obligimet mund të maten edhe me vlerën e tregut kur nje gjë e tillë është e mundur. Për të vërë në përdorim vlerën e tregut atëher pa dyshim se duhet të egzistoi një treg aktiv ku kuotohen pasuritë apo detyrimet financiare me vlerë të krahasueshme.

3.7. Patundshmëritë Impiantet dhe paisjet.

Patundshmëritë dhe paisjet janë vlerësuar në bazë të kostos historike duke zbritur me zhvlersimin e akumuluar dhe provizionimin e aseteve te hequra prej përdorimi dhe me shtimet për riparimet ose zëvendsimet e pjesëve esenciale sipas kategorisë se pasurive. Kostoja e blerëjes përfshinë të gjitha shpenzimet që kanë marrë pjesë në blerjen e pasurive. Kostoja e zëvendësimit të një pjese të pasurisë ose paisje njihet në vlerën bartëse të njësisë, në rastet kur me shumë arsye pritr që të mirat në të ardhmën do të rrjedhin në entitet, dhe nese kostoja e tyre mund të matet në mënyrë të besueshme. Shpenzimet e bëra për mirmbajtjen e pasurive njihen si shpenzime të periudhës dhe të njëjtat barten në “Pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve” për atë periudhë.

3.8. Zhvlerësimet

Zhvlerësimet njihen në “Pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve” me metoden saldo zbritese për gjat jetë-gjatësisë së secilës pasuri apo paisje ose (pjese të pasurisë ose paisjesë) siq vijon :

- Ndertesa dhe objektet tjera 5 %
- Makinerit e rënda 15%
- Paisjetdhe Inventaret të tjera 20 %

3.9. Pasuritë e pa-trupezuara.

Pasuritë e pa-trupezuara konsiderohen të gjitha pasuritë që nuk janë të prekëshme si gjesende, por që kanë vlerën e tyre të pamohueshme. Keto pasuri njihen vetëm pasi të maten me besueshmeri perfitimet që sjell rrjedha e keshit me përdorimin e këtyre pasurive.Pasuritë e tilla janë: Programet e kontabilitetit “Softëar-at”, Patentet, Liçencat etj.

3.10. Pasuritë (mjetetë) financiare

Pasuritë ose mjetet financiare klasifikohen si kategoritë vijuese: Mjete financiare në vlerën reale për mes fitimit apo humbjes, avanset, parapagimet, të arkëtueshmet që nuk mbahen për shitje si dhe të arkëtueshmet të gatëshme për shitje. Klasifikimi varet nga natyra dhe

qëllimi i njeteve financiare varësisht se kur janë siguruar. Menaxhmenti përcakton klasifikimin e mjeteve në njohjen fillestatre të tyre. Gjerë në datën e bilancit të gjendjes Organizata nuk ka pasuri të klasifikuara në kategoritë e vlerës reale për mes fitimit apo humbjes të gatëshme për shitje. Blerjet dhe shitjet e mjeteve financiare njihen në datën e tregëtimit, që është data kur Organizata kryenë blerjen apo shitjen e pasurisë.

Avanset dhe të arketueshmet janë mjete financiare jo-derivative me pagesa fikse apo të përcaktuara që nuk janë kuotuar në një treg aktiv. Këto pasuri janë të përfshira në mjetet rrjedhëse, përveq atyre me maturitet më të madhë se 12 muaj, pas datës së bilancit të gjendjes. Këto mjete janë klasifikuar si pasuri jo-rrjedhëse. Avanset dhe të arketueshmet e Kompanisë përbëhen prej të arketueshmeve tregëtare dhe të arketueshmet tjera, si dhe parasë dhe ekuivalentëve të sajë siq barten në bilanc.

3.11. Të arketueshmet tjera dhe tregëtare.

Të arketueshmet tjera dhe tregëtare njihen në fillim në vlerën e tyre reale dhe paraprkishtë të matura me koston e amortizimit duke përdorur metoden efektive të interesit, minus provizionet për dëmet. Provizionet për dëmet e të arketueshmeve tregëtare është vendosur aty ku ka dëshmi të mjaftueshme që Organizata nuk do të jetë në gjendje të mbledhë të gjitha shumat sipas kushteve origjinale të të arketueshmeve. Vështërsitë e mëdha financiare, mospagesa apo gabimi në pagesa (si ato që vonohen më tepër se 30 ditë) konsiderohen si indikator që të arketueshmet tregëtare janë dëmtuar.

Shuma e provizionit është diferenca në mes pasurive që bartin shumën bartëse dhe vlera prezente e vlerësuar e rrjedhës së parasë së ardhëshme, zbritur me normën origjinale efektive të interesit. Pasuritë me maturitet afatshkurtër nuk janë të zbritura. Vlera bartëse e mjeteve zvogëlohet për mes përdorimit të një kontoje për lejim, dhe shuma e humbjes njihet në "Pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve". Kur një e arketueshme tregëtare është e pa-mbledhëshme shlyhet kundër kontos për lejimet e të arketueshmeve tjera e tregëtare.

3.12. Paraja dhe ekuivalentët e sajë

Paraja dhe ekuivalentët e sajë pasqyrohen në "Bilancin e gjendjes" sipas koston. Për qëllime të "Pasqyrës së fluksit të parasë" paraja dhe ekuivalentët e sajë përfshijnë paranë e vogël në arkat e Kompanisë si dhe gjitha dispozitat e mbajtura në bankë si dispozita apo plasmane.

3.13. Fondi i Organizatës

Fondi I organizatës përbëhet nga vlera reale dhe monetare kontribuar nga anëtarët e organizatës. Fondi I organizatës përmbledhë fondin themeltar të organizatës si dhe Tepricat / Mungesat të periudhave të kaluara dhe periudhës ushtrimore.

3.14. Përfitimet e punëtorve dhe kostot e pensioneve

Në pajtim me "Rregulloret fiskale" në Kosovë, konkretisht konform Ligjit 05/L-28 "Mbi tatimin në të ardhurat personale", Organizata duhet të ndalë në burim dhe të paguan tatimin

në të ardhura personale për dhe në llogari të të punësuarëve të vetë. Kontributet pensionale dhe tatimet në të ardhura personale pastaj ngarkohen në të ardhurat bruto të stafit dhe paraqiten si shpenzime operative të periudhës konkrete.

Organizata nuk llogarit provizion dhe nuk ka asnjë obligim për pensionet e punonjësve për dhe mbi kontributet e paguara në planin e pensionit të detyrueshëm, Trustin e Kursimeve Pensionale të Kosovës (TKPK).

3.15. Të pagueshmet tjera dhe tregëtare.

Të pagueshmet tjera dhe tregëtar njihën në vlerën reale dhe më pastaj maten me kostot e amortizimit duke përdorur metodën efektive të interesit.

3.16. Tatimet (rrjedhës dhe i shtyrë).

Per aktivitetet jo komerciale - Organizata është organizatë jo profitabile dhe nuk shpërndanë fitim, kështu që sipas legjislacionit në fuqi nuk është subjekt i tatimit në të ardhura.

Per aktivitetet komerciale – Organizata vepron ne perputhje me:

- Kapitulli VIII Dispozitat e Veçanta Neni 34 Trajtimi i të Ardhurave Komerciale të Organizatave Joqeveritare Ligji Nr. 06/L -105 Për Tatimin Në Të Ardhurat E Korporatave.
- Neni 34 - Trajtimi i të ardhurave komerciale të organizatave joqeveritare (Udhëzimi Administrativ Nr. 02/2016)
- Kkapitulli VIII lirimet pa të drejtën e zbritjes së TVSH-së së zbritshme neni 27 lirimet për aktivitetet e caktuara me interes publik, paragrafët: 1.14. - 1.14.1. dhe 1.14.2.

3.17. Njohja e të ardhurave dhe shpenzimeve.

Të ardhurat

Të ardhurat njihen atëherë kur është e mundur që benefitet e ardhshme ekonomike do të rrjedhin në Organizatë dhe këto benefite të mund të maten besueshëm.

Organizata njih të ardhurat duke i ngarkuar llojet në vazhdim: Tarifat e anëtarësisë dhe tarifat edukimit njihen fillimisht kur lëshohet fatura. Të hyrat rregullohen në fund të vitit për të reflektuar vetëm të hyrat e fituara gjatë vitit.

Shpenzimet operative

Shpenzimet e direkte programore dhe shpenzimet tjera indirekte njihen në bazë akruale që d.m.th atëherë kur ato ndodhin.

3.18. Provizionet

Provizioni njihet kur Organizata ka një obligim të tanishëm si rezultat i ngjarjeve të kaluara dhe mundësia është që një rrjedhë e burimeve të i shoqëroj beneficionet ekonomike që do të jenë të kërkuara të vendoset obligimi. Provizionet janë rishikuar në ç'do datë të bilancit të

gjendjes dhe janë rregulluar ashtu që të reflektoj parashikimet më të mira të tanishme. Kur ndikimi i vlerës në kohë të parasë është materiale, shumica e provizionit është vlera e tanishme e shpenzimeve të pritura që do të kërkohen të vendosen obligimet.

3.19. Raportimet jashta politikave të rëndësishme kontabël

Në të gjitha rastet kur entiteti ka përdorur një politikë tjetër kontabël që nuk është në pajtim të plotë me politikat e rëndësishme kontabël të cilat i kemi shënuar më lartë, atëherë duhet pajtim tjetër që të shpalojë ky ndryshim i politikave duke bërë theks të posaqëm në notën e politikës së rëndësishme kontabël dhe duke shtuar një notë tjetër të theksimit se për çfarë arsye është ndryshuar politika kontabël e entitetit. Në gjitha rastet kur ndryshimi i bërë vë në kundërshtim me SNRF-të, SNK-të, ose SKK-te, atëherë entiteti do të shpalojë edhe një notë shtesë për të treguar arsyen pse është përdorur një politikë e tillë duke sqaruar se me politikat e rëndësishme kontabël që janë në pajtim të plotë me SNRF-të, SNK-të, do të raportojë për një gjendje jo reale të entitetit, në gjitha rastet tjera nuk aplikohet politikë tjetër që nuk është në pajtim me SNRF-të SNK-të.

3.20. Te ndryshme

Menaxhmenti i Kompanisë duhet që të implementoi në tërësi politikat e rëndësishme kontabile si dhe ta menaxhoi implementimin e tyre në mënyrë të vazhdueshme dhe me kujdesin e duhur të rishikoi efektet e implementimit, për të pasur një vijimësi të sigurt në aktivitetet e veta ekonomike. Pasqyrat financiare janë përgatitur në euro dhe janë të rrumbullaksuara në të qintën e euros apo në euro-cent.

3.21. Paraqitja e granteve që lidhen me pasuritë (SNK 20)

Grantet qeveritare që lidhen me pasuritë, përfshirë grantet jo monetare me vlerë të drejtë, duhet të paraqiten në pasqyrën e pasqyra e pozicionit financiar ose duke e njohur grantin si të ardhur të shtyrë ose duke zbritur grantin që merret nga vlera e mbartur e pasurisë. Dy metodat e paraqitjes në pasqyrat financiare të granteve (ose pjesëve të caktuara të granteve) që lidhen me pasuritë, shihen si alternativa të pranueshme.

Njëra metodë njeh grantin si të ardhur të shtyrë e cila njihet si e ardhur në një mënyrë sistematike dhe racionale gjatë jetës së dobishme të pasurisë.

Metoda tjetër zbrit grantin që merret nga vlera kontabël e pasurisë. Granti njihet si e ardhur gjatë jetës së aktivitetit të amortizueshëm duke pakësuar shumën e amortizimit.

Blerja e pasurisë dhe arkëtimi i granteve përkatëse mund të shkaktojë lëvizje të rëndësishme në fluksin e mjeteve monetare të një njësie ekonomike. Për këtë arsye dhe me qëllim që të tregohen investimet bruto në pasuri, lëvizje të tilla shpesh paraqiten si zëra të veçantë në pasqyrën e fluksit të mjeteve monetare pavarësisht nëse granti zbritet ose jo nga pasuria që lidhet me të për qëllime të paraqitjes në pasqyrën e pasqyra e pozicionit financiar.

4. Paraja dhe ekuivalentët e parasë

Paraja dhe ekuivalentet e parasë përfshijnë paratë që entiteti i mban në arken e vetë për qëllime të pageses së shpenzimeve operative dhe për nevoja tjera të pa parashikuara si dhe paratë që entiteti i ka si depozituara në bankat tjera. Gjendja e parasë siq janë pasqyruar në bilancin e gjendjes në këtë notë është si vijonë:

	31 dhjetor 2024	31 dhjetor 2023
	(në Euro)	(në Euro)
Paraja në arkë	157	123
Paraja në bankë	59,486	61,200
Total	59,642	61,323

5. PASURITË TJERA

	31 dhjetor 2024	31 dhjetor 2023
	(në Euro)	(në Euro)
Kërkesat ndaj klientëve	-	-
Parapagimet e dhena	-	6,593
Kapitali I arketueshem	-	-
Total	-	6,593

6. LLOGARITË E ARKËTUESHME TREGTARE DHE TË TJERA

7. PRONA, IMPIANTET DHE PAISJET

	Automjete	Pajisje për zyre	Inventar	Tjera	Total
Kosto historike					
Më 1 janar 2023	-	1,700	-	-	1,700
Shtesat gjatë vitit	-	4,734	-	-	4,734
Më 31 dhjetor 2023	-	6,434	-	-	6,434
Shtesat gjatë vitit	-	8,722	-	-	8,722
Heqjet nga përdorimi	-	-	-	-	-
Më 31 dhjetor 2024	-	15,156	-	-	15,156
Zhvlërësimi i akumuluar:					
Më 1 janar 2023	-	340	-	-	340
Zhvlërësimi për vitin	-	375	-	-	375
Më 31 dhjetor 2023	-	715	-	-	715
Zhvlërësimi për vitin	-	2,691	-	-	2,691
Heqjet nga përdorimi	-	-	-	-	-
Më 31 dhjetor 2024	-	3,406	-	-	3,406
VLERA NETO E ASETËVE					
Më 31 dhjetor 2023	-	5,719	-	-	5,719
Më 31 dhjetor 2024	-	11,750	-	-	11,750

8. LLOGARITË E PAGUESHME TREGTARE DHE TË TJERA

9. DETYRIMET TJERA

	31 dhjetor 2024	31 dhjetor 2023
	(në Euro)	(në Euro)
Detyrimet ndaj pagave	-	2,735
Pensionet	1,805	1,172
Tatimi ne paga	1,512	964
Tatimi ne qira		712
Te hyrat e shtyera	68,075	68,053
Tatime Tjera	-	-
Total	71,392	73,636

10. Fondi

11. TË HYRAT

Për vitin që përfundon me 31 dhjetor	31 dhjetor 2024	31 dhjetor 2023
Te hyrat nga projektet	228,930	64,901
Te hyrat nga shërbimet	600	5,570
Totali i të Hyrave	229,530	70,471

12. TË HYRAT TJERA

13. SHPENZIMET

13.a SHPENZIMET E PAGAVE BRUTO

Për vitin që përfundon me 31 dhjetor	31 dhjetor 2024	31 dhjetor 2023
Pagat	157,186	46,321
Kontributi penzional I punëdhënesit	-	5,189
TAP mbajtur ne burim	-	3,957
Total	157,186	55,467

13.b Shpenzimet administrative

Për vitin që përfundon me 31 dhjetor	31 dhjetor 2024	31 dhjetor 2023
Shpenzimet per projektin	43,791	5,255
Shpenzimet operative		583
Pajisje		540
Shpenzimet e Qirasë	14,505	5,637
Interenet dhe telefon	362	217
Shpenzimet për ujë	780	-
Mirembajtja	218	135
Shpenzimet e bankes	596	183
Furnizim per zyre	2,893	534
Shp. Udhetimit dhe akomodimit	2,222	237
Shpenzimet e konferences	-	370
Shpenzimet tjera	4,285	939
Total	69,653	14,631

13.c SHPENZIMET Tjera

Për vitin që përfundon me 31 dhjetor	31 dhjetor 2024	31 dhjetor 2023
Shpenzimet e qirasë	-	-
Shpenzimet e zhvleresimit	2,691	374
Total	2,691	374

14. Transaksionet me palët e lidhura

15. KONTINGJENTET DHE ZOTIMET

Zotimet kapitale

Nuk ka ndonjë zotim kapital domethënës të kontraktuar në datën e bilancit të gjendjes që tani më nuk është njohur në pasqyrat financiare.

Detyrimet kontingjente

Me 31 dhjetor 2024, Organizata nuk është e përfshirë në asnjë çështje gjyqësore nga aktiviteti i rregullt.

16. NGJARJET PASUESE

Ngjarjet pas përfundimit të vitit raportues në bilancin e gjendjes, dhe të cilat japin informacione shtesë për pozitën e Organizatës në datën e bilancit të gjendjes (ngjarjet rregulluese) janë të reflektuara në pasqyrat financiare.

Ngjarjet pas përfundimit të vitit të cilat nuk janë të rregulluara janë shpalosur në shenimet plotësuese gjithëher kur ngjarja reflekton vlera materiale.

Nuk ka ngjarje të tjera pas datës së përfundimit të periudhës raportuese, që mund të kishin nevojë për përmirësime apo shpalosje shtesë në këto pasqyra financiare.